



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr i faq/Br str/No.pg 44

Data/Datum/Date 30/03/2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17 dhe nenit 40 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazetën zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008"), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 pika 2.3 dhe 2.6, nenit 65 paragrafi 1 pika 1.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, e në mbështetje të Rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20 të datës 29.06.2020, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Për faljen e borxhit të pa paguar për taksën në aktivitet (afariste)

Neni 1

Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të pa paguar për taksën në aktivitet (afariste), për të gjithë taksapaguesit e Komunës së Rahovecit nga data 1.1.2000 deri më 31.12.2017.

Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të pa paguara për taksën në aktivitet (afariste), të gjitha borxhet e taksapaguesve, përfitues nga periudha e cekur në nenin 1, të këtij vendimi nga zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8, të Rregullores (QRK) Nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.44/23
Me datë:30.03.2023


Defrim Kafexhju
Kryesues i Kuvendit